

Marrë në dorëzim: 03.03.2025			
Mj. Org.	Numri	Shtojcë	Vlera
LAP	18		

1953



INSTITUTI I STUDIMEVE
PËR KRIMET DHE PASOJAT
E KOMUNIZIMIT

INSTITUTI ALBANOLOGJIK
I PRISHTINËS

INSTITUTI I STUDIMEVE
PËR KRIMET DHE PASOJAT
E KOMUNIZIMIT

Nr. 18 prot.
Datë 03.03.2025

Nr. 75 prot.
Datë 03.03.2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Institut i pavarur publik me qendër në Tiranë, me NIPT L11618454G, me seli në adresën: Rruga "e Saracëve", i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Çelo Hoxha, më poshtë cilësuar si "ISKK".

dhe

Instituti Albanologjik i Prishtinës me adresë Rruga "Eqerem Çabej" Prishtinë, i përfaqësuar nga Drejtori Z.Naim Berisha, këtu e mëposhte cilësuar si "Instituti".

Palët me mirëkuptim midis tyre, lidhin këtë Memorandum si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i një kornize bashkëpunimi të ndërsjellë në fushat e kërkimit shkencor, edukimit, botimeve dhe projekteve të ndryshme, duke siguruar respektimin e legjislacionit në fuqi. Këto aktivitete do të kenë si qëllim kryesor informimin e komunitetit mbi pasojat e regjimit komunist, duke ofruar një kuptim të thelluar të pasojave historike dhe sociale që ka lënë ky regjim.

Bashkëpunimi do të përfshijë gjithashtu mundësinë e organizimit të seminareve, konferencave dhe shfaqjeve që do të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike për periudhën komuniste, si dhe edukimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e këtyre ngjarjeve.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Ky Memorandum bazohet në: Ligjin nr.10 242 datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri*" neni 5 germat "f", "h", "i", dhe Kodin Civil.

NENI 3

ANGAZHIMET E PALEVE

1. Palët do të organizojnë dhe marrin pjesë në konferenca, seminare dhe aktivitete të përbashkëta.
2. Palët mund të organizojnë gjithashtu seminare, konferenca dhe aktivitete kulturore/sociale, që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta të këtij bashkëpunimi.
3. Palët angazhohen gjithashtu për organizimin e aktiviteteve edukative dhe kulturore, përfshirë zhvillimin e ekspozitave, leksioneve dhe aktiviteteve të tjera, që mund të realizohen individualisht ose në bashkëpunim me institucione lokale.
4. Bashkëpunimi do të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve arsimore dhe kërkimore, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive në fushat përkatëse.

NENI 4

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Cdo rregullim ose ndryshim në këtë Memorandum bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve, dhe nuk shoqërohet me kosto financiare.
2. Cdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

NENI 5
HYRJA NE FUQI

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar.

Bërë në _____, më datë ____ .2025, në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe, ku të katër tekstet janë njëjloj të vlefshëm.

PËR INSTITUTIN

DREJTORI

NAIM BERISHA



PËR ISKK

DREJTORI EKZEKUTIV

CELO HOXHA

